

sondazh i opinionit publik

2016

BESIMI NË QEVERISJE



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Sondazh i opinionit publik

BESIMI *në* QEVERISJE 2016



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

© 2016 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN)
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, 1. PO BOX 8177 Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@idmalbania.org
Website: www.idmalbania.org

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) ose të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet rezultatet e sondazhit publik të kryer gjatë periudhës 12-24 dhjetor 2016 në 61 bashkitë e Shqipërisë. Qëllimi i sondazhit është shqyrtimi i nivelit të besimit ndaj institucioneve publike, qëndrimet ndaj performancës së institucioneve publike si dhe ofrimit të shërbimeve në vend. Duke përdorur metodën e kampionimit me kuota, u pyetën 1647 qytetarë lidhur me nivelin e tyre të perceptimit të besimit, transparencës, përgjegjshmërisë, pjesëmarrjen në proceset vendim-marrëse dhe përdorimin e teknologjisë. Më poshtë, një përmbledhje e rezultateve kryesore të organizuara sipas seksioneve tematike:

BESIMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE:

- Institucionet/organizatat ndërkombëtare si **BE** (80%), **NATO** (79%) dhe **OKB** (79%) vazhdojnë të renditen si institucionet më të besuara në Shqipëri, duke gëzuar besimin e rreth 4 në 5 shqiptarëve të anketuar. Këto institucione gëzojnë gjithashtu përqindjen më të madhe të qytetarëve që shprehin besim të madh (në një interval prej 34-36%)
- **Institucionet fetare** gëzojnë vlerësimin më të lartë të besimit tek institucionet publike kombëtare në kategorinë “Kam shumë besim”. 22% e qytetarëve të anketuar shprehen se kanë shumë besim në institucionet fetare. Megjithatë, nëse merren së bashku këto kategori (“Kam shumë besim” ose “Kam besim”), qytetarët e anketuar besojnë më shumë **policinë** (61%), **sistemin arsimor** (59%), **institucionet fetare** (58%), **median** (58%) dhe **Forcat e Armatosura** (55%).
- 44% e shqiptarëve të anketuar kanë besim tek **qeveria qendrore**, në krahasim me 49% që kanë besim tek **qeverisja** e tyre **vendore**
- **Sistemi gjyqësor** (74%) është institucioni më pak i besuar në Shqipëri, i ndjekur me një diferencë të përafërt nga **partitë politike** (72%). **Parlamenti** renditet si institucioni i tretë më pak i besuar, me 71% të publikut të anketuar që nuk kanë besim.
- Në përgjithësi, popullsia më e madhe në moshë e shoqërisë shqiptare, individët e **punësuar** (në veçanti, punonjësit në sektorin publik), dhe qytetarët që banojnë në **zonat urbane**, mesatarisht, prirën të kenë më shumë besim institucional.
- Edhe pse 71% e qytetarëve të anketuar besojnë se Reforma në Drejtësi do të ketë ndikim pozitiv nëse zbatohet siç duhet, vetëm 46% e tyre besojnë se Reforma në Drejtësi do të zbatohet siç duhet në krahasim me 42% që nuk ndajnë të njëjtin mendim.

- 35% e qytetarëve të anketuar mendojnë se informacioni i dhënë nga mediat nuk është i saktë dhe i vërtetë. 74% e qytetarëve të anketuar kanë televizionin si mediumin e tyre mediatik më të përdorur.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA:

- Pikëpamja se qeveria qendrore është **transparente** mbahet nga 39% e qytetarëve të anketuar në krahasim me 61% të atyre që nuk pajtohen me këtë pohim. Në nivelin e qeverisjes vendore, 43% e të anketuarve besojnë se bashkia e tyre është transparente.
- 36% e qytetarëve të anketuar e perceptojnë qeverinë të jetë e përgjegjshme në veprimet e saj, përkundrajt 64% të të anketuarve që nuk janë dakord. Në nivelin e qeverisjes vendore, 33% e të anketuarve besojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme.
- 36% e qytetarëve të anketuar e perceptojnë qeverinë të jetë e **përgjegjshme** në veprimet e saj, përkundrajt 64% të të anketuarve që nuk janë dakord. Në nivelin e qeverisjes vendore, 33% e të anketuarve besojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme.
- 63% e qytetarëve të anketuar besojnë se Kontrolli i Lartë i Shtetit mban përgjegjësi qeverisë.

KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE:

- **Sistemi gjyqësor** renditet nga ana e qytetarëve të anketuar (34%), si institucioni më i korruptuar për vitin 2016. **Qeveria qendrore** zë vendin e dytë (28%), e ndjekur nga **Parlamenti** (15%).
- Për vitin 2016, 26% e qytetarëve të anketuar deklaruan se **u kanë paguar** ryshfet zyrtarëve publikë në nivel qendror në krahasim me 29% e qytetarëve në njësitë e qeverisjes vendore. Të pyetur për arsytet, 58% e tyre kanë deklaruar se u është **kërkuar hapur nga autoritetet qeveritare**, 20% ka dhënë ryshfet si mirënjohje për shërbimin e marrë, ndërsa 22% si nxitje për të marrë **shërbime më të mira** në të ardhmen.

PËRFAQËSIMI QYTETAR:

- 79% e qytetarëve të anketuar kanë perceptimin se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendim-marrëse/konsultimet me institucionet në nivel qendror, në krahasim me 67% në nivel vendor.
- 7% e qytetarëve të anketuar në nivel qendror dhe 19% në nivel vendor **janë ftuar** të marrin pjesë në **procese konsultuese** gjatë vitit 2016.

- Për vitin 2016, 22% e qytetarëve të anketuar kanë marrë pjesë në demonstratë/tubim ose kanë nënshkruar një peticion.
- 77% e të anketuarve shprehen të gatshëm për t'u angazhuar në **punë vullnetare** për të mirën e komunitetit.

KËNAQSHMËRIA LIDHUR ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE TIK:

- Qytetarët janë kryesisht të kënaqur me furnizimin me **ujë të pijshëm** (72%), **shërbimet e policisë** (66%) dhe **shërbimet e pastrimit** (të ofruara në nivel lokal) (61%).
- Në anën tjetër, më shumë se gjysma e qytetarëve nuk janë të kënaqur me **shërbimet e punësimit** (78%), me **shërbimet gjyqësore** (66%), si dhe me **shërbimet e mirëqenies sociale** (60%).
- Klasifikimi **urban-rural** duket se është një faktor përcaktues pas nivelit të kënaqshmërisë, pasi qytetarët që jetojnë në zonat rurale kanë më shumë gjasa të raportojnë nivele të ulëta të kënaqshmërisë lidhur me ofrimin e shërbimit publik në krahasim me ata që jetojnë në zonat urbane.
- Vetëm 28% e qytetarëve të anketuar besojnë se institucionet që ofrojnë shërbime publike i dëgjojnë dhe **trajtojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët**, në krahasim me 46% të cilët nuk kanë besim.
- 42% e qytetarëve të anketuar janë në dijeni për ekzistencën e një **faqe interneti** në bashkitë e tyre përkatëse. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre ose 59% nuk e përdorin faqen e internetit dhe vetëm 34% e tyre janë të informuar në lidhje me **shërbimet elektronike** të ofruara nga bashkitë e tyre.

GJINIA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE:

- 48% e qytetarëve të anketuar besojnë se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare. Ky besim ndahet nga vetëm 37% e grave, në krahasim me 55% të burrave.
- 59% e qytetarëve të anketuar mendojnë se burrat dhe gratë kanë akses të njëjtë në shërbimet publike. Ky besim ndahet nga vetëm 55% e grave, në krahasim me 63% e burrave.
- 6% e të anketuarve raportojnë se janë **trajtuar ndryshe** nga një institucion/nënpunës civil gjatë vitit 2016 **në bazë të gjinisë së tyre**.
- Sa i përket grave në vendimmarrjen vendore, vetëm 24% e qytetarëve të anketuar kanë dijeni se ka më shumë gra në këshillat e tyre përkatëse bashkiake, në krahasim me 57%, të cilët nuk janë në dijeni të **përbërjes gjinore** në këshillat e tyre bashkiake

PASQYRA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
PASQYRA E LËNDËS	8
HYRJE	9
METODOLOGJIA	10
GJETJET	13
Besimi në Institucionet Publike	13
Transparenca dhe llogaridhënia	24
Korrupsioni në institucionet publike	34
Ndikimi politik në punën e institucioneve publike	37
Angazhimi qytetar	39
Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	46
TIK (Përdorimi i Teknologjisë)	52
Gjinia dhe Përfshirja sociale	55
REFERENCAT	61
SHTOJCA 1	62
SHTOJCA 2	63
POSHTËSHENIME	65

HYRJE

Besimi në qeverisje është i rëndësishëm për suksesin e një game të gjerë politikash publike që varen nga mënyra e reagimit të publikut. Shkalla e besimit ndikon në vullnetin e qytetarëve dhe të biznesit për t'iu përgjigjur politikave publike dhe për të kontribuar për një rimëkëmbje të qëndrueshme ekonomike. Është vërejtur gjithashtu se kapaciteti i qeverisë dhe cilësia e qeverisë kanë ndikim të fortë në pothuajse të gjitha standardet e mirëqenies, si dhe të besimit social dhe legjitimitetit politik. Dëshmitë gjithashtu tregojnë se kënaqshmëria nga ofrimi i shërbimeve publike lidhet pozitivisht me besimin e qytetarëve tek qeveria dhe qeverisja. Më tej, adresimi i pabarazive dhe miratimi i politikave të përshtatshme për një rritje gjithëpërfshirëse kontribuojnë në besimin e qytetarëve tek institucionet. Sondazhi i Opinionit Publik “Besimi në Qeverisje” është një instrument për monitorimin e standardeve të qeverisjes së hapur, angazhimin qytetar dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri, në baza vjetore.

Ky raport paraqet gjetjet e sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje” (që më pas do të quhet Sondazhi i Opinionit) të kryer gjatë periudhës 12-24 dhjetor 2016 në të 61 bashkitë e Shqipërisë. Ai siguron njohuri lidhur me besimin publik, perceptimet dhe qëndrimet për çështje të tilla si: besimi në institucionet publike, transparencën dhe llogaridhënia institucionale, niveli i korrupsionit, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve publike, niveli i përfshirjes së qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje si dhe zbatimin e ligjeve dhe i politikave jo-diskriminuese.

Sondazhi i Opinionit ofron të dhëna për monitorimin dhe vlerësimin e reformave të mëdha që Shqipëria po ndërmerr, të tilla si “*Reforma Territoriale dhe Administrative*”, “*Reforma në Administratën Publike*”, si dhe zbatimin e nismave kombëtare dhe ndërkombëtare si “*Partneriteti për Qeverisje të Hapur*”. Për më tepër, Sondazhi i Opinionit kontribuon në matjen dhe monitorimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në Shqipëri - duke u fokusuar në gjenerimin e të dhënave të rëndësishme për treguesit e Objektivit 16 “Promovimi i shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse”. Gjetjet janë krahasuar me gjetjet nga vitet e mëparshme (duke filluar nga viti 2013) si dhe janë paraqitur korrelacionet e mundshme mes treguesve specifikë të tillë si besimi, shkalla e korrupsionit, kënaqshmëria nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i TIK-ut.

Ky është viti i katërt radhazi (2013-2016) që ky Sondazh i Opinionit po kryhet, bazuar në metodologji, instrument dhe mbulim kombëtar të ngjashëm. Të dhënat mblidhen çdo vit në muajt nëntor-dhjetor.

METODOLOGJIA

Sondazhi i Opinionit ka për qëllim të shqyrtojë shkallën e besimit të publikut ndaj institucioneve publike si dhe të shqyrtojë qëndrimet e qytetarëve ndaj performancës së institucioneve publike dhe ofrimit të shërbimeve. Si e tillë, ai ka nevojë për një qasje metodologjike sasiore. Për këtë qëllim, instrumenti kërkimor, i përdorur në vitet paraardhëse është administruar me një kampion prej **1647 të anketuarish**, duke synuar një **mbulim gjeografik kombëtar**.

U përdor *për qasja e kampionimit me kuota (sampling quota)* për të përzgjedhur një numër të barabartë të anketuarish nga secila prej 61 njësi të qeverisjes vendore në vend (n=27).¹ Përveç kësaj, u përdorën kontrollet e kuotave për klasifikimin gjinor dhe atë urban-rural. Në përzgjedhjen e kuotave të barabarta për secilën fushë, qëllimi ishte që të përfshihet një larmi e madhe e profileve të të anketuarve në lidhje me moshën, nivelin arsimor, statusin e punësimit, si dhe të ardhurat; edhe pse disa nga këto karakteristika nuk mund të parapërcaktohen meqenëse përzgjedhja e të anketuarve kushtëzohet nga madhësia paraprake e numrit të të përzgjedhurve në zonat administrative në Shqipëri. Teknika e kampionimit, edhe pse kampionim pa probabilitet që nuk lejon përgjithësime të të gjithë popullsisë, është më e përshtatshme, kur synohet t'i jepet i njëjti “zë” opinionit të të gjithë qytetarëve, pavarësisht afërsisë me qeverinë qendrore, shërbimet e centralizuara etj.

Ky është viti i 4-t radhazi që Sondazhi i Opinionit kryhet me të njëjtat pyetje bazë mbi Besimin tek Qeverisja, Shkalla e Korrupsionit, TIK dhe Përfshirja Qytetare, për të siguruar krahasueshmërinë me vitet e mëparshme. Megjithatë, për shkak të zhvillimeve të fundit në nivel kombëtar (Reforma Territoriale dhe Administrative, Reforma në Administratën Publike) dhe në nivel ndërkombëtar (miratimi i treguesve të OZHQ-së), janë shtuar grupe të reja pyetjesh për të mundësuar matjen e treguesve përkatës. Përmbajtja e pyetësorit është shqyrtuar nga një panel ekspertësh, i përbërë nga ekspertë në fushën e mirë-qeverisjes, anti-korrupsionit, qeverisjes lokale, ekonomisë, sociologjisë dhe të sigurisë.

Puna në terren u krye në periudhën **12-24 dhjetor 2016**. Pyetësori u realizua me intervista individuale ballë-për-ballë, duke përdorur metodën PAPI (intervistë personale e asistuar me shkrim). Të dhënat u përpunuan dhe analizuan për të paraqitur statistikat përshkruese dhe relacionale, duke përdorur STATA 12.0.

Kufizimet

Duke qenë se qëllimi përfundimtar ishte t'i jepej “zëri” të gjithë qytetarëve pavarësisht afërsisë me qeverinë qendrore, u përdor kampionimi me kuota, i cili u bazua në dy karakteristika kryesore: gjinia dhe vendndodhja (urbane ose rurale). Karakteristika të tjera në nivel individual, si moshja dhe të ardhurat, mund të mos jenë të mirë-përfaqësuar në kampionin përfundimtar.²


Edhe pse sondazhi u krye përgjatë të 12 qarqeve të vendit, rezultatet nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë e vendit. Megjithatë, këto gjetje përvijojnë një panoramë të perceptimeve publike dhe shfaqin trendet në kohë.³

DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

U anketuan në nivel kombëtar një numër i përgjithshëm prej 1647 qytetarësh shqiptarë të moshës 18 vjeç e lart. Të dhënat kryesore demografike të kampionit përfundimtar të të anketuarve në lidhje me gjininë, moshën, arsimin, statusin e punësimit dhe të ardhurat individuale jepen më poshtë.


Gr. 1

Përfaqësimi gjinor



Gr. 2


Klasifikimi gjeografik



Kampioni përfshiu 57% burra dhe 43% gra. 51% banojnë në zona urbane dhe 49% në zona rurale. Moshë mesatare është 42 vjeç (DS=15)⁴ në një interval nga 18-91 vjeç. Për shpërndarjen e moshës sipas grup-moshave të ndryshme shih grafikun 3.

Gr. 3


Grup-moshat



Për sa i përket nivelit të arsimimit (grafiku 4), paksa më shumë se 5 në 10 qytetarë të anketuar kanë përfunduar shkollën e mesme dhe rreth 24% kanë ose janë në procesin e marrjes së një diplome universitare ose pasuniversitare. Rreth 19% kanë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm.

Gr. 4

Niveli i Arsimit



Për sa i përket statusit të punësimit, rreth 43% e të anketuarëve ishin të punësuar në momentin e intervistës (me 32% e të punësuarve që punojnë në sektorin publik, ndërsa 68% në sektorin privat). 8% e të anketuarve ishin studentë dhe 12% në pension. Për më tepër, 25% e të anketuarëve u shprehën se kanë jetuar jashtë vendit për të paktën një vit.


Tabela 1. Statusi i punësimit

Të punësuar	Sektori Publik 32%	43%
	Sektori Privat 68%	
	Të papunë	35%
	Studentë	8%
	Pensionistë	12%
	Të tjerë	2%

Shpërndarja e të ardhurave mujore individuale të të anketuarëve paraqitet në grafikun 5.

Gr. 5

Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)



GJETJET

BESIMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Besimi në institucionet apo besimi institucional nënkupton pritshmërinë individuale që një institucion i dhënë do të japë rezultate pozitive (Levi dhe Stoker 2000). Duke u ndalur në besimin politik, Hetherington (1998) e konsideron besimin një funksion të vlerësimit institucional, konsideratave politike të qytetarëve⁵, cilësisë së rezultateve të politikave, raportimit të medias⁶, perceptimeve rreth ndryshimeve sociale dhe kulturore, por edhe karakteristikave socio-demografike, të tilla si moshë, arsimit, të ardhurat dhe gjinia.

Siç theksohet nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD 2013), besimi në institucionet publike është i rëndësishëm për suksesin e një game të gjerë të politikave publike, programeve dhe rregulloreve që varen nga bashkëpunimi dhe respektimi i qytetarëve. Mungesa e besimit kompromenton vullnetin e qytetarëve dhe bizneseve për t'iu përgjigjur politikave publike, duke penguar zhvillimin e qëndrueshëm.

“Besimi në institucione” përfaqëson një nga modulet kryesore të Sondazhit të Opinionit. Në mënyrë të veçantë, qytetarët pyeten që të vlerësojnë se sa ata personalisht i besojnë një grupi institucionesh kryesore publike dhe politike në nivel qendror dhe vendor, si dhe aktorëve⁷ të tjerë të rëndësishëm në një shkallë me katër pikë nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam fare besim). Kur qytetarët shprehen se ata besojnë në institucione të caktuara⁸, ne supozojmë se mendimi i tyre është i bazuar në imazhet institucionale që ata kanë ndërtuar, çka përkon me kriteret përkatëse të përgjithshme ose normative që ata përdorin në vlerësimin e tyre. Supozimi themelor këtu është se për të ndërtuar përfytyrimet e tyre lidhur me institucionet publike, qytetarët nuk duhet të dinë në detaje se si institucionet e ndryshme janë projektuar; ata zhvillojnë pritshmëritë në lidhje me institucionet në fjalë.

Grafiku 6 përmbledh shpërndarjen e rezultateve.

Të dhënat për vitin 2016 tregojnë se institucionet ndërkombëtare / organizatat si **BE, NATO** dhe **OKB**-ja, vlerësohen si institucionet më të besuara në Shqipëri, duke gëzuar besimin e rreth 4 në 5 shqiptarëve të anketuar (respektivisht 80%, 79%, 79%).⁹ Po kështu, këto institucione gëzojnë gjithashtu përqindjen më të madhe të qytetarëve që shprehin shumë besim (në një interval prej 34-36%).

Nga ana tjetër, vetëm pesë në trembëdhjetë (5/13) institucione kombëtare gëzojnë më shumë se 50% të besimit të publikut, çka përvijon një prirje të përgjithshme të besimit të ulët në institucionet publike kombëtare.

Në nivel të përgjithshëm¹⁰, qytetarët e anketuar kanë më shumë besim tek **Policia** (61%), **sistemi arsimor** (59%), **instiucionet fetare** (58%), **media** (58%) dhe **Forcat e Armatosura** (55%).

Megjithatë, **instiucionet fetare** duket se gëzojnë vlerësimin më të madh të besimit tek instiucionet kombëtare nëse marrim në konsideratë kategorinë “Kam shumë besim”. 22% e qytetarëve të anketuar shprehen se ata kanë shumë besim tek instiucionet fetare, krahasuar me 12% që kanë shumë besim tek policia.

Me një diferencë prej 5% nga njëra-tjetra,¹¹ qeveria vendore duket se gëzon besim më të madh se sa qeveria qendrore. 44% e shqiptarëve të anketuar besojnë tek **qeveria qendrore**, përkundrajt 49% që besojnë tek **qeveritë** e tyre **vendore**.

Edhe pse ata që besojnë tek qeveria qendrore janë në pakicë (44%), qeveria qendrore gëzon më shumë besim se Parlamenti, i cili konsiderohet i besueshëm vetëm nga 27% e publikut të anketuar.

Publiku është i dyzuar lidhur me shoqërinë civile, pasi në të njëjtin raport, 46% e qytetarëve të anketuar shprehin besimin tek **Organizatat e Shoqërisë Civile** (OSHC-të), ndërkohë që 46% e tyre në përgjithësi janë të prirur të mos besojnë tek OShC-të. 7% e tyre nuk kanë ndonjë mendim.

Në anën tjetër, **Sistemi Gjyqësor** (74%) është institucioni me më pak besim në Shqipëri¹², i ndjekur me një diferencë të ngjashme nga partitë politike (72%). Më shumë se një në çdo tre qytetarë të anketuar nuk kanë “fare besim” në këto institucione (36% dhe 35%, respektivisht). Parlamenti renditet si institucioni i tretë më pak i besuar, me 71% të publikut të anketuar që nuk ka besim.¹³

Krahasimi socio-demografik


Pas paraqitjes së dinamikës agregate të besimit, vërejmë se besimi në institucione specifike varion midis segmenteve të ndryshëm të popullsisë shqiptare.

Tabela 2 përmbledh rezultatet e analizës relacionale sipas karakteristikave bazë socio-demografike.

Në një nivel agregat,¹⁴ duket se ka pak ndryshim në besueshmërinë institucionale midis gjinive në përgjithësi. Megjithatë, popullsia më e re në moshë ka më shumë gjasa të raportojë nivele më të larta të mosbesimit në krahasim me **segmentet më të mëdha në moshë** të shoqërisë shqiptare, të cilat, mesatarisht, priren të jenë më besimplotë. Për sa i përket situatës së punësimit, pjesa e **punësuar** e demografisë priret të ketë më besim dhe për më tepër, brenda kësaj kategorie, ky perceptim është më i theksuar tek të punësuarit në sektorin publik. Klasifikimi urban-rural gjithashtu paraqitet përcaktues; qytetarët që banojnë në zonat urbane kanë më shumë besim, mesatarisht, në krahasim me ata në zona rurale.

Gr. 6

Besimi Institucional 2016



Nëse do të përqëndrohemi në institucione të veçanta, të dhënat tregojnë se:

- **Qeveria qendrore** konsiderohet më e besueshme nga popullsia më e madhe në moshë (50% midis 56-65 vjeç dhe 53% midis mbi 66 vjeç), nga individë me arsim të lartë (50%), nga të punësuarit në sektorin publik (63%) dhe individë që jetojnë në zonat urbane (46%).
- Besimi tek **Policia** priret të jetë më i lartë tek popullata e moshuar (65% midis 56-65 vjeç dhe 76% tek mbi 66 vjeç), individët me arsim të lartë (64%), të punësuarit në sektorin publik (73%) dhe individët që jetojnë në zonat urbane (64%).
- Besimi tek **OShC**-të priret të jetë më i lartë tek femrat (49%), grup-moshat 18-25 vjeç (51%) dhe ata me moshë mbi 66 vjeç (50%), si dhe tek qytetarët me arsim të lartë (56%).

Tabela 2. Tabela e analizës relacionale “Kam shumë besim” ose “Kam besim” 15

	Forcat e armatosura	Institucionet Fetare	Policia	Media	Qeveria	Qev. Lokale	Arsimi	Shoq. Civile	Kujdesi shëndetësor	Parlamenti	Presidenti	Partitë politike	Gjyqësori
TOTALI (I besimit)	55%	58%	61%	58%	44%	49%	59%	46%	50%	27%	36%	23%	23%
Gjinia													
Mashkull	56%	57%	61%	59%	45%	51%	59%	44%	49%	26%	38%	24%	23%
Femër	54%	58%	60%	58%	42%	48%	60%	49%	51%	28%	35%	22%	24%
Mosha													
18-25	51%	55%	55%	58%	40%	44%	59%	51%	49%	21%	32%	21%	23%
26-35	53%	54%	59%	56%	40%	45%	56%	45%	47%	27%	34%	20%	24%
36-45	52%	63%	57%	54%	42%	51%	59%	46%	45%	24%	37%	21%	18%
46-55	58%	59%	63%	58%	38%	47%	59%	46%	51%	27%	37%	22%	22%
56-65	55%	56%	65%	62%	50%	53%	62%	42%	54%	31%	42%	30%	27%
Over 66	74%	66%	76%	68%	63%	69%	67%	50%	62%	40%	40%	32%	29%
Niveli i Arsimit													
Arsimi Bazë	56%	57%	61%	60%	43%	49%	57%	45%	49%	27%	33%	22%	22%
Shkollë e Mesme	54%	59%	59%	58%	41%	48%	59%	43%	50%	24%	36%	23%	23%
Universitet	58%	58%	64%	58%	50%	53%	63%	56%	51%	32%	40%	23%	24%
Statusi i punësimit													
Të punësuar	58%	60%	63%	56%	49%	55%	64%	49%	56%	32%	40%	26%	24%
Publik	65%	56%	73%	57%	63%	65%	72%	54%	63%	47%	47%	33%	34%
Privat	51%	60%	58%	56%	41%	50%	59%	46%	50%	24%	36%	23%	21%
Të papunë	50%	54%	54%	53%	31%	37%	51%	43%	40%	17%	32%	17%	20%
Pensionistë	69%	66%	75%	71%	61%	65%	67%	47%	52%	38%	41%	32%	30%
Studentë	52%	52%	63%	63%	44%	53%	64%	55%	61%	27%	34%	23%	22%
Zona													
Urbane	58%	59%	64%	59%	46%	52%	60%	47%	52%	25%	37%	25%	22%
Rurale	52%	57%	58%	58%	41%	47%	59%	46%	48%	28%	36%	21%	24%

Krahasimi në kohë

Degët e qeverisjes


Grafiku 7 përshkruan evolucionin e besimit në të tri pushtetet e qeverisjes.

Besueshmëria e publikut mbetet element kyç për funksionimin e suksesshëm në të gjitha pushtetet e qeverisjes. Në mënyrë të veçantë, besimi është i rëndësishëm për pushtetin legjislativ, i cili lidhet me qytetarët në mënyrë më të drejtpërdrejtë - përmes zgjedhjes së përfaqësuesve llogaridhënës ndaj qytetarëve në kohën e zgjedhjeve. Por, siç ka qenë rasti me Sondazhin e Opinioneve që nga viti 2013, publiku shqiptar duket se vazhdon të mbështesë pushtetin ekzekutiv, ndërsa vazhdon erozioni i besimit tek pushteti legjislativ dhe ai gjyqësor.

Në vitin 2016, përqindja e shqiptarëve të anketuar që shprehën besim tek pushteti gjyqësor është më e ulët (23%), i ndjekur nga pushteti legjislativ i besuar me vetëm 27% të publikut të anketuar. Pushteti ekzekutiv (44%) mbetet me diferencë të madhe më i besuari nga të tre pushtetet.

Gr. 7

Besimi në tre degët e qeverisjes 2015-2016




Shënim: % e qytetarëve të anketuar që shprehin “Kam shumë besim” ose “Kam besim”.

Në këtë aspekt, grafiku 8 paraqet evoluimin e besimit në pushtetin ekzekutiv në mënyrë më të detajuar. Megjithatë, nëse janë apo jo të anketuarit në gjendje të bëjnë dallimin midis nocionit të “qeverisë” si institucion dhe partisë/partive në pushtet, mbetet shumë e debatuar në literaturë, kryesisht për shkak se mbështetësit e një partie në detyrë priren të raportojnë nivele të dukshme më të larta besimi tek qeveria (Citrin 1974, Norris 1999).

Të dhënat sugjerojnë se ndërsa kategoria “Kam shumë besim”, ka mbetur mjaft konstante përgjatë katër viteve që nga viti 2013, ka pasur disa rritje të lehta në kategorinë “Kam besim”. Ndryshimet më të mëdha mund të vërehen në kategorinë “Nuk kam fare besim”, e cila ka zbritur nga 42% në vitin 2013, në 20% në vitin 2016.

Gr. 8

Evoluimi i besimit në qeverinë qendrore 2013-2016




Institucionet e tjera publike

Kur bëhet krahasimi me vitin 2015, analiza tregon se ka pasur një prirje të përgjithshme në rritje tek publiku shqiptar lidhur me shkallën e besimit të tyre në institucionet publike. Pavarësisht nga fakti se besimi tek institucionet administrative ishte më i madh se tek ato përfaqësuese, vektori i ndryshimit duket se shkon në mënyrë paralele. Shih grafikun 9 për ecurinë e ndryshimit të besimit të ndarë sipas kategorive të ndryshme të matjes.

Gr. 9

Ndryshimi i besimit (pikë përqindje: p.p) 2015-2016




Sistemi arsimor (26 p.p) dhe sistemi shëndetësor (23 p.p) kanë parë rritjen më të lartë në nivelin e besimit të përgjithshëm. Media gjithashtu regjistron një rritje prej 19 p.p.

Që nga viti 2013, për 4 vite radhazi, Bashkimi Evropian dhe NATO-ja janë institucionet më të besuara në Shqipëri, ndërsa partitë politike dhe Gjyqësori mbeten institucionet më pak të besuara.

Shih grafikun 10 për rezultatet që nga viti 2013.


Gr. 10
Besimi Institucional (2013-2016)

Besimi 2013




Gr. 10
Besimi Institucional (2013-2016)

Besimi 2014




Gr. 10
Besimi Institucional (2013-2016)

Besimi 2015



Gr. 10
Besimi Institucional (2013-2016)

Besimi 2016



Për këtë vit, pyetjet kryesore lidhur me besimin institucional u plotësuan me pyetje të tjera duke mundësuar kështu që Sondazhi i Opinioneve t'i përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme në diskursin publik.


Reforma në Drejtësi

Gjatë vitit 2016, tema e Reformës në Drejtësi dominoi pjesën më të madhe të diskutimit publik. Në korrik të vitit 2016, ndryshimet kushtetuese lidhur me organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë u miratuan unanimisht, duke nisur një proces të plotë dhe gjithëpërfshirës për reformën e gjyqësorit - e cila është në vazhdim e sipër.

Të pyetur për këtë çështje, shumica ose 71% e qytetarëve të anketuar besojnë se nëse zbatohet siç duhet, Reforma në Drejtësi do të ketë një ndikim pozitiv, krahasuar me vetëm rreth 18% të publikut që nuk e ndan këtë besim. Megjithatë, publiku mbetet i dyzuar në perceptimet lidhur me zbatimin e duhur të reformës; vetëm 46% e qytetarëve besojnë se Reforma në Drejtësi do të zbatohet siç duhet në krahasim me 42% që nuk ndan të njëjtin mendim.


Gr. 11

A besoni se Reforma në Drejtësi do të ketë një impakt pozitiv?



Gr. 12

A besoni se Reforma në Drejtësi do të zbatohet në përputhje objektivat?



Analiza socio-demografike tregon se pjesa më e madhe e atyre që nuk kanë besim tek zbatimi i duhur i reformës, priren të jenë brezat e rinj (53% e moshës 18-24 vjeç, në krahasim me 35% të moshës mbi 55 vjeç), si dhe individët e papunë në momentin e intervistës (50%).


Media

Ky nën-seksion synon të analizojë marrëdhëniet e qytetarëve me median dhe informacionin që ajo prodhon. Pas pyetjes së të anketuarëve lidhur me burimin e tyre më të përdorur të informacionit, janë analizuar pikëpamjet e tyre mbi besueshmërinë dhe vërtetësinë e raportimit të mediave.

Në literaturë, masmedia është përmendur shpesh si një faktor i rëndësishëm në riformëzimin e politikës bashkëkohore dhe nxitjen e mosbesimit (Norris 2000, Newton 1997). Lidhur me këtë, rezultatet tona tregojnë se mjete mediatik më popullore për shqiptarët e anketuar mbetet televizioni: 74% e qytetarëve të anketuar e vlerësojnë atë si mjete mediatik më të shfrytëzuar (shih grafikun 13). Më tej, platformat e rrjeteve sociale renditen si mediumi i dytë më popullore me 19% të qytetarëve që raportojnë se i përdorin më shpesh. Ndarja e brezave është e qartë - afërsisht një në dy persona të moshës 18-25 vjeç (49%) përmendin mediat sociale si mediumi i tyre më i përdorur, i ndjekur nga televizioni (41%).

Gr. 13

Mjete mediatik më i përdorur




Vetëm një në çdo dy qytetarë të anketuar mendon se informacioni i dhënë nga media është i saktë dhe i vërtetë, në krahasim me 35% të atyre që nuk mendojnë kështu. Analiza socio-demografike tregon se kjo pikëpamje afirmative priret të jetë më mbizotëruese në pjesën e popullsisë me moshë më të madhe (54% e 46-65 vjeçarëve dhe 67% të moshës mbi 65 vjeç) dhe më pak të arsimuar (60% me arsim bazë).

Nga ana tjetër, kur pyeten nëse informacioni i dhënë nga media është i dëmshëm¹⁶, 45% e qytetarëve të anketuar besojnë se nuk është i dëmshëm, ndërsa 43% e tyre besojnë se është i dëmshëm.


Gr. 14

A është informacioni i dhënë nga media i saktë/i vërtetë?



Gr. 15

A është informacioni i dhënë nga media i dëmshëm?



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA


Transparenca konsiderohet sot si një mjet kryesor i mirë-qeverisjes dhe një parakusht për çdo regjim demokratik dhe si e tillë, reformat që kanë për qëllim nxitjen e një administrate më transparente mbështeten nga shumica e qeverive. Megjithë përdorimin e shumtë të termit, praktikuesit dhe studiuesit ende mbajnë përkufizime të ndryshme të termit. Disa prej tyre e përqendrojnë vëmendjen mbi ligjet e tw Drejtws së Informimit (LI), disa përqendrohen në qeverisjen elektronike dhe disa të tjerë përqendrohen në efektet e transparencës, duke supozuar se ajo gjeneron besueshmëri më të madhe, më shumë pjesëmarrje, një administratë më efikase dhe më pak korrupsion.

Për qëllime të kësaj analize, ne i referohemi Grimmeliikhuijsen-it dhe Welch-it (2012), të cilët kanë propozuar një nga përkufizimet më të fundit të transparencës, e cila merr parasysh të dyja marrëdhëniet shtet-qytetar.¹⁷

Sipas të dhënave, **39% e qytetarëve të anketuar** pajtohen me deklarinim “qeveria qendrore është transparente” përkundrejt **61% të cilët nuk pajtohen me këtë deklarinim.**

Gr. 16

Qeveria qendrore është transparente



Krahasimet socio-demografike tregojnë se nuk ka ndryshim (të konsiderueshëm) midis burrave dhe grave lidhur me perceptimet rreth transparencës së qeverisë qendrore.

Tabela 3. Transparenca e Qeverisë qendrore sipas gjinisë


Transparenca e Qeverisë qendrore		
	Burrë	Grua
Po	38.0%	40.0%
Jo	62.0%	60.0%

Duke iu referuar pushtetit në nivel vendor, 43% e qytetarëve të anketuar pajtohen me deklarinse bashkia është transparente, ndërsa 57% nuk pajtohen me këtë deklarinse.

Duke i krahasuar të dyja, të dhënat tregojnë se, me një ndryshim të vogël prej 4%, qytetarët e anketuar besojnë se bashkia është më transparente se qeveria qendrore.

Gr. 17

Bashkia është transparente



Nga pikëpamja socio-demografike, të dhënat tregojnë se nuk ka dallim mes burrave dhe grave rreth perceptimeve të tyre për transparencën bashkiake (Tabela 5). Nga ana tjetër, banorët në zonat urbane prirën të besojnë më shumë në transparencën bashkiake (48%), në krahasim me ata që jetojnë në zonat rurale (39%) (Tabela 4).

Tabela 4. Transparenca bashkiake sipas zonave

Transparenca bashkiake		
	Rurale	Urbane
Po	39.0%	48.0%
Jo	59.0%	50.0%

Tabela 5. Transparenca bashkiake sipas gjinisë


Transparenca bashkiake		
	Rurale	Urbane
Po	44.0%	43.0%
Jo	55.0%	53.0%

Liria e informimit kërkohet gjerësisht të jetë e garantuar me ligj. Parimi kryesor lidhur me legjislacionin për lirinë e informimit është se njerëzit kanë të drejtë të dinë lidhur me aktivitetet e autoriteteve publike, përveç rasteve kur ligji shprehet ndryshe. Në Shqipëri, Ligji nr. 114/2014 "Për të drejtën e informimit" u miratua më 18 shtator 2014. Ligji garanton të drejtën e informimit dhe transparencën ndaj qytetarëve shqiptarë. Sipas nenit 3 të Ligjit, garantohej sa më poshtë:

Qytetarët u pyetën nëse ata janë në dijeni se në Shqipëri e drejta e informimit garantohej me ligj. 57% e qytetarëve të anketuar thonë se ata e dinë se në Shqipëri "e drejta e informimit" është e garantuar me ligj, përkundër 43% të qytetarëve të anketuar, të cilët nuk janë në dijeni të këtij fakti.

Gr. 18

Ndërgjegjësimi për
"Të drejtën e Ligjit mbi Informimit"



1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.


4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Ligji 114/2014 kërkon nga institucionet publike (në nivel qendror dhe vendor) të miratojnë programet e transparencës dhe të emërojnë Koordinatorët për të drejtën e informimit. Bazuar në këtë, qytetarët e anketuar u pyetën nëse ata i kishin paraqitur ndonjë kërkesë për informacion një institucioni publik gjatë vitit 2016.

Afërsisht 1 në 4 (23%) e të anketuarve (N=217)¹⁸ thonë se në vitin 2016, kanë paraqitur një kërkesë për informacion në institucionet publike, dhe 70% e atyre që kanë dorëzuar kërkesën (N = 167) kanë marrë informacionin e kërkuar.


Gr. 19

Kërkesë e paraqitur
për informacion



Gr. 20

Marrë informacioni
i kërkuar



Sipas një raporti monitorimi të kryer nga BIRN-Albania në vitin 2016¹⁹, “bashkitë në Shqipëri janë më transparente lidhur me dokumentacionet dhe informacionin për kategoritë e “E drejta e informimit” “Këshilli bashkiak”. Në të kundërt, kategoritë ku ato janë më pak transparente janë: “transparenca financiare”, “legjislacioni” dhe “Konsultimi publik”

Llogaridhënia


Njëllor si me transparencën, koncepti i llogaridhënies është një koncept që ka qenë prej kohësh në qendër të teorisë dhe praktikës së administratës publike dhe qeverisjes, megjithatë përkufizimi i tij mbetet i papërcaktuar qartë. Të jesh përgjegjës do të thotë të kesh detyrimin të japësh llogari, të shpjegosh dhe justifikosh veprimet e tua në aspektin e kriterëve të duhura dhe në detaje të mjaftueshme.

Bazuar në shpjegimin e mësipërm, qytetarët u pyetën nëse ata perceptojnë se qeveria qendrore dhe ajo vendore janë të përgjegjshme, dmth. që i shpjegojnë veprimet (ose mos-veprimet) e tyre qytetarëve.

Të dhënat tregojnë se 36% e të anketuarve besojnë se qeveria është e përgjegjshme për veprimet (ose mos veprimet) e saj, përkundrajt 64% të të anketuarve të cilët nuk pajtohen me këtë.

Gr. 21


Llogaridhënia e Qeverisë Qendrore



Duke iu referuar pushtetit vendor, të dhënat tregojnë se 43% e të anketuarve besojnë se Bashkia është përgjegjëse për veprimet (ose mosveprimet) e saj, ndërsa 54% e qytetarëve të anketuar nuk pajtohen me këtë. 3% e të anketuarve refuzuan të përgjigjen, ose nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.

Gr. 22

Llogaridhënia e Bashkisë




Sipas Bankës Botërore (2012), koncepti i llogaridhënies mund të klasifikohet sipas llojit të përgjegjshmërisë së ushtruar dhe/ose personit, grupit ose institucionit të cilit nëpunësi publik i përgjigjet, duke pranuar dy forma kryesore: llogaridhënien horizontale dhe llogaridhënien vertikale.

“Llogaridhënia horizontale” është kapaciteti i institucioneve shtetërore për të kontrolluar abuzimet nga agjencitë e tjera publike dhe degët e pushtetit, ose kërkesa ndaj agjencive për të raportuar tërthorazi.

Gr. 23

Mekanizmat e llogaridhënies horizontale




Përsa i përket mekanizmave horizontale të llogaridhënies (Grafiku 23), 63% e qytetarëve të anketuar besojnë se Kontrolli i Lartë i Shtetit i kërkon qeverisë llogari, ndjekur nga Parlamenti dhe partitë e opozitës (51% e qytetarëve të anketuar) dhe deputetët (46% e qytetarëve të anketuar).

Nga ana tjetër, **llogaridhënia vertikale** është mjeti përmes së cilit qytetarët, masmedia, shoqëria civile, komuniteti i biznesit, sindikatat, etj. mbajnë përgjegjësin institucionet publike.²⁰

Gr. 24

Mekanizmat e llogaridhënies vertikale




Përsa i përket mekanizmit vertikal të llogaridhënies, 62% e qytetarëve të anketuar besojnë se media i kërkon llogari qeverisë, e ndjekur nga shoqëria civile (46% e qytetarëve të anketuar) dhe biznesi (me 43%). Sipas të dhënave, 55% e qytetarëve të anketuar besojnë se sindikatat nuk mbajnë përgjegjëse qeverinë.

Së fundmi, ekspertët sugjerojnë termin **llogaridhënie administrative**, e cila ushtrohet kryesisht përmes institucioneve, si avokati i popullit, auditues dhe inspektorë të pavarur, si një formë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të pavarur dhe të jashtëm administrativ dhe financiar. Kjo formë llogaridhënie është e ndryshme për marrëdhëniet klasike nga lart-poshtë/agent kryesor sepse institucioni administrativ përgjegjës nuk është në një marrëdhënie hierarkike me zyrtarët publikë dhe shpesh nuk ka kompetenca zyrtare që të detyrojë zyrtarët publikë të binden.²¹

Gr. 25


Përgjegjësia administrative



Duke iu referuar konceptit të llogaridhënies administrative, 54% e qytetarëve të anketuar besojnë se Avokati i Popullit i kërkon llogari qeverisë, ndërsa vetëm 46% e të anketuarve besojnë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e bën këtë (Grafiku 25).

Gr. 26

Ndryshimi në llogaridhënie 2015-2016 (p.p.)



Nga një perspektivë e krahasimit në kohë, në krahasim me 2015, organizatat e shoqërisë civile, Avokati i Popullit dhe sindikatat perceptohen se kanë një rol në rritje në bërjen e qeverisë përgjegjëse, me një rritje në pike përqindje prej përkatësisht 11%, 9% dhe 4%. Nga ana tjetër, Parlamenti dhe deputetët perceptohen të kenë një rol në zbritje (ulje respektivisht 28 p.p. dhe 27 p.p). Për klasifikimin e rezultateve, shih grafikun 26.

KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE


Transparency International e përkufizon përgjithësisht korrupsionin si abuzim me pushtetin e deleguar për përfitime private. Kjo mund të ndodhë kudo dhe mund të klasifikohet si korrupsion i madh ose i vogël, në varësi të shumës së parave të përvetësuara dhe të sektorit ku ndodh ky korrupsion.

Për qëllimin e këtij sondazhi të Opinioneve Publike, korrupsioni konsiderohet kur ndodh në institucionet publike (qeveria dhe njësitë vendore), të cilat në punën e tyre përdorin fondet publike dhe ofrojnë shërbime me motivimin për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe jo për të gjeneruar fitime. Në bazë të këtij vlerësimi, çdo lloj abuzimi i pushtetit të besuar për përfitime private që ndodh tek organet e qeverisjes qendrore apo vendore konsiderohet si korrupsion në sektorin publik.

Qytetarët u pyetën se cili është institucioni publik më i korruptuar. Qytetarët e anketuar renditën sistemin gjyqësor si institucionin më të korruptuar për vitin 2016 (34% i të anketuarve). Qeveria u rendit si institucioni i dytë më i korruptuar nga 28% e të anketuarve, e ndjekur nga Parlamenti, me 15% të qytetarëve.²²

Gr. 27

Institucioni më i korruptuar 2016




Më tej, qytetarët u pyetën në lidhje me ekspozimin e tyre personal ndaj korrupsionit. Për vitin 2016, vetëm 10% e qytetarëve të anketuar raportuan përballje personale me korrupsionin

në nivelin e qeverisë qendrore, kurse shumica (90%) e qytetarëve të anketuar raportojnë se nuk kanë qenë personalisht dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni. Nga ana tjetër, në nivel vendor, kjo përqindje rritet në 15% të qytetarëve të cilët kanë qenë personalisht dëshmitarë të një rasti korrupsioni.

Gr. 28


Përballja personale me korrupsionin 2016



Gjatë vitit 2016, 52% e qytetarëve të anketuar raportuan se kanë marrë të paktën një shërbim nga institucionet publike të **qeverisjes në nivel vendor** kundrejt 48% që nuk kanë marrë ndonjë shërbim publik. Ndërkohë në nivel vendor, 25% e qytetarëve të anketuar raportuan të kenë marrë shërbime nga **bashkia** kundrejt 75% që kanë deklaruar të kundërtën.

Gr. 29


Shërbime të marra nga institucionet publike 2016



Për të matur korrupsionin në të dy nivelet e qeverisjes, qytetarët që pohuan se kanë marrë shërbime nga qeveria qendrore dhe vendore gjatë vitit 2016, janë pyetur më tej nëse ka ndodhur t'u kenë paguar ryshfet nëpunësve publikë për shërbimet e marra. 26% e tyre²³ (N=105) raportuan se u kanë paguar ryshfet nëpunësve publikë në nivel qendror, ndërsa 29% e tyre (N = 240) raportuan se u kanë paguar ryshfet nëpunësve në qeverisjes vendore.

Gr. 30

Ryshfet një nëpunësi civil 2016



Në lidhje me arsyet mbi pagimin e një ryshfeti nëpunësve publikë, 58% e qytetarëve deklaruan se kanë paguar ryshfet për shkak se u është kërkuar nga autoritetet publike. Më tej, 20% e qytetarëve deklaruan se ryshfeti është dhënë si mirënjohje për shërbimin e marrë dhe 22% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kanë dhënë ryshfet për të marrë shërbime më të mira në të ardhmen.

Më tej, të anketuarit të cilët pranuan se kanë paguar ryshfet gjatë 12 muajve të fundit, u pyetën nëse e kishin raportuar këtë fenomen pranë autoritetit/institucionit zyrtar përkatës. Të dhënat tregojnë se 5% e qytetarëve, të cilët kanë paguar ryshfet (N = 13) deklaruan se e kanë raportuar një rast të tillë, ndërsa shumica (95% ose N = 229) e qytetarëve deklaruan që nuk e kanë raportuar këtë rast abuziv.

Për më tepër, të pyetur mbi arsyet e mos-raportimit, 32% (N = 81) e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se ryshfeti shihet si një kulturë, një praktikë e zakonshme apo një shenjë mirënjohjeje, 14% (N = 36) e qytetarëve besojnë se ryshfeti nuk e ndryshon korrupsionin si fenomen, i cili nuk adresohet. Megjithatë, një pjesë e madhe e qytetarëve 40% (N = 101), deklarojnë që nuk i njohin autoritetet përkatëse, të cilëve u duhet raportuar. 7% e qytetarëve të anketuar (N = 17) deklaruan se nuk e kanë raportuar rastin e korrupsionit për shkak të frikës nga ndëshkimi.


NDIKIMI POLITIK NË PUNËN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Çdo veprim rregullator i ndërmarrë nga një qeveri me qëllim që të ndikojë ose të ndërhyjë tek vendimet e marra nga individët, grupet ose organizatat në lidhje me çështjet sociale dhe ekonomike konsiderohet ndërhyrje e interesave politike në punën e përditshme të institucioneve publike. Në një shkallë nga 1 (aspak me ndikim) deri në 5 (me ndikim shumë të madh), **72% e qytetarëve të anketuar e shohin gjyqësorin si më të prekshëm ndaj ndikimit politik**. Nga ana tjetër, perceptimi ndaj institucioneve fetare është se ato janë më të pavarura nga ndikimi politik. 47% e qytetarëve të anketuar besojnë se politika nuk ka fare ndikim në punën e institucioneve fetare.



Gr. 31

Ndikimi politik në punën e institucioneve publike 2016



ANGAZHIMI QYTETAR

Angazhimi qytetar përbën esencën e një qeverisje të mirë, shpesh duke qenë një lidhje jetike mes transparencës dhe llogaridhënies. Në një botë gjithnjë e më komplekse, inputet e qytetarëve kthehen në një burim kritik për politikë-bërjen. Vendimmarrja e mirë kërkon njohuritë, përvojat, mendimet dhe vlerat e publikut. Zbatimi i vendimeve të vështira varet nga miratimi dhe mbështetja e qytetarëve. Nëse qytetarët nuk i kuptojnë dhe nuk janë të angazhuar në proceset vendimmarrëse, besimi humbet lehtësisht (OECD, 2009).

Është e rëndësishme që angazhimi qytetar të programohet mirë dhe të ketë burime të mjaftueshme dhe të lindë nga një dëshirë e vërtetë për të përfshirë publikun dhe për të marrë kontributin e tyre në konsideratë. Angazhimi i mirë qytetar mund të mbështesë funksionimin efektiv të demokracisë, legjitimitetin e qeverisë, zbatimin e suksesshëm të politikave dhe arritjen e rezultateve sociale. Praktika të dobëta të këtij angazhimi mund të çojnë në vendime të dobëta dhe mosangazhim të qytetarëve (Brodie et al, 2011).


Në Shqipëri, Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është miratuar më 14 tetor 2014. Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve që lindin në një proces të konsultimit publik, midis palëve të interesuara Publike, qendrore dhe lokale, në procesin e vendimmarrjes duke iu referuar akteve ligjore, dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me rëndësi të lartë publike. Në nivel qendror, është krijuar Regjistri elektronik www.konsultimipublik.gov.al, me qëllim për të rritur komunikimin midis institucioneve qeveritare dhe qytetarëve (grupeve të interesit) në funksion të proceseve të konsultimit. Megjithatë, platforma nuk ka arritur potencialin e saj të plotë, dhe aktualisht ka një profil të ulët. Ndërkohë, ministrinë përdorin faqet e interneti zyrtare për të drejtuar proceset e konsultimit elektronik, edhe pse kjo ndodh në baza ad hoc. Ligji shtrin kompetencat e tij edhe në nivel lokal, duke i kërkuar Bashkive për të krijuar dhe për të bërë plotësisht funksional mekanizmat për të siguruar procesin e konsultimit me qytetarët. Neni 10 i Ligjit 146/2014 i kërkon Njësive të Qeverisjes Vendore që të caktojnë një koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Qytetarëve, që iu nënshtruan këtij sondazhi, u janë bërë disa pyetje me qëllim për të parë qendrimin e tyre në lidhje me çështjet e angazhimit qytetar në proceset e konsultimit publik në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Të dhënat tregojnë se në qeverisjen **në nivel qendror, 79% e të anketuarve** thonë se ata nuk ndihen se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes/konsultimeve me institucionet në nivel qendror, dhe vetëm **21% e të anketuarve**, thonë se kanë mundësi të mjaftueshme për t'u angazhuar.

Gr. 32

Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrje 2016




Ndërsa në nivel vendor, 33% e të anketuarve perceptojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për t'u angazhuar në proceset vendimmarrëse në bashkinë e tyre, ndërsa **67% perceptojnë se nuk i kanë këto mundësi**. Sipas studimit të kryer nga BIRN Albania²⁴ që ka monitoruar 61 Bashkitë mbi nivelin e zbatimit të Ligjit për të Drejtwn e Informimit dhe të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, 39 % e të anketuarve besojnë se Bashkitë në përgjithësi i kanë përmbushur detyrimet ligjore për të siguruar konsultim publik.

Duke eksploruar më tej, qytetarët u pyetën nëse gjatë vitit 2016, kanë qenë të ftuar të marrin pjesë në ndonjë nga këto procese si në nivel qendror dhe vendor. Të dhënat tregojnë se në nivel qendror, vetëm 7% kanë marrë një ftesë të tillë (N = 109), ndërsa 93% jo. Në nivel vendor, vetëm 19% e të anketuarve që janë ftuar (N = 1520) kanë marrë pjesë.

Të anketuarit të cilët ishin të ftuar të marrin pjesë, janë pyetur më tej nëse iu përgjigjën kësaj ftese dhe kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit. Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e të ftuarve, kanë marrë pjesë në procese të tilla (62% në nivel qendror dhe 68% në nivel vendor). Kjo çon në supozimin se qytetarët janë të interesuar të bëhen pjesë e procesit të konsultimit në të dyja nivelet e qeverisjes dhe nëse u jepet mundësia, ata do ta përdorin atë.


Gr. 33

Ftesë për të marrë pjesë në proceset konsultuese 2016



Gr. 34

Pjesëmarrje në konsultime 2016



Qytetarët të cilët nuk iu përgjigjën ftesës dhe nuk morrën pjesë në proceset e konsultimit janë pyetur më tej për të shpjeguar arsyet e rolit të tyre pasiv. 64% e tyre²⁵ thonë se “nuk besojnë në procese të tilla”; 17% thonë se presin që të tjerët ta bëjnë këtë dhe 10% thonë se nuk kanë informacion mbi temën që diskutohet.

Tabela 6. Arsyet për të mos marrë pjesë

Pres që të tjerët të marrin pjesë	17%
Unë nuk besoj në procese të tilla	64%
Unë nuk kam informacion mbi temën në diskutim	10%
Unë nuk munda të shkoj në vendndodhje	8%
Të tjera	1%

Mungesa e besimit në vërtetësinë e proceseve të konsultimit publik mund të jetë shkaktuar nga rrethana kur institucionet publike nuk arrijnë të demonstrojnë se si merren në konsideratë reagimet, sugjerimet që vijnë nga qytetarët dhe/ose aktorë të tjerë, ose, të shpjegojnë pse këto sugjerime nuk mund të përshtaten në dokumentin e miratuar të politikës.

Gjithashtu, kur u pyetën për të mbajtur një qëndrim mbi tri deklaratatë të veçanta që lidhen me angazhimin qytetar, të dhënat tregojnë se:

- 72% e të anketuarve besojnë se një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq; megjithatë
- 57% e të anketuarve besojnë se dëgjuesat publike vendore janë ngjarje formale me ndikim të kufizuar në vendimet bashkiake; dhe
- 54% e të anketuarve besojnë se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet merren në konsideratë.

Edhe pse gjatë 2016 organizata të shoqërisë civile dhe grupe të tjera të interesit kanë bërë thirrje dhe kanë organizuar demonstrata dhe protesta (peticione të nënshkruara) që synojnë fusha të ndryshme të politikës, vetëm 22% e të anketuarve raportojnë se kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla. Sipas tyre, arsyeja kryesore ishte “Interesi i përbashkët i komunitetit, të cilit i përkasin (43% e të anketuarve)”.


Gr. 35

Deklaratat e angazhimit qytetar

Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq

Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet merren në konsideratë

Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet bashkiake



Shënim: Përgjigjet "Pa opinion" nuk janë paraqitur në grafik.

Gr. 36

A keni marrë pjesë në një demonstratë/tubim ose nënshkruar një peticion në 2016?





Tabela 7. Arsyet e angazhimit qytetar

Interesi personal	20%
Interesi i përbashkët i komunitetit të cilit i përkas	43%
Militantizmi i partive politike	12%
Presioni i grupit	3%
Një kombinim i më shumë se një arsye	22%

Pyetja e fundit për sa i përket angazhimit qytetar kishte për qëllim të eksploronte qëndrimin e qytetarëve mbi punën vullnetare. 77% e të anketuarve janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Analiza socio-demografike tregon se brezat e rinj kanë tendencë të jenë më të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare (86% e 18-25 vjeçarëve në krahasim me 77% të 46-55 vjeçarëve).

Gr. 37

Angazhimi i mundshëm në punë vullnetare



KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Reagimet (feedback) e rregullta qytetare mbi cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike kanë rëndësi të veçantë në vendet në tranzicion, ku marrëdhëniet midis politikëbërësve, ofruesve të shërbimeve dhe qytetarëve janë transformuar si rrjedhojë e reformave të ofrimit të shërbimeve duke vënë në qendër qytetarin.

Gjatë vitit 2016, një ligj i ri për ofrimin e shërbimeve në sportel ka hyrë në fuqi,²⁶ ndjekur nga miratimi i një dokumenti politikash të ofrimit të shërbimit duke pasur në qendër qytetarin me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe rritjen e komenteve / sugjerimeve nga qytetarët.²⁷

Në pesë bashki, u eksperimentua *një zyrë me një ndalesë (one stop shop)* për shërbimet publike. Që nga viti 2015, Shqipëria ka ndërmarrë një ndarje të re administrative-territoriale²⁸, e cila parashikon 61 bashki. Në janar të vitit 2016, hyri në fuqi ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,²⁹ që parashikon decentralizimin e një numri të madh të kompetencave tek bashkitë e konsoliduara.

Në këtë kontekst, Sondazhi i Opinioneve Publikë kishte për qëllim të maste nivelin e kënaqshmërisë publike ndaj shërbimeve publike të ofruara nga një numër institucionesh publike në 12 muajt e fundit. Shërbimet publike të zgjedhura janë ato që qytetarët marrin në bazë ditore (p.sh. transport publik, furnizim me ujë të pijshëm), ose mjaft shpesh (p.sh. shërbime shëndetësore, shërbime komunale etj.) të ofruara si nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore.

Një përshkrim i detajuar i këtyre rezultateve mund të gjendet në grafikun 38.

Të dhënat e 2016 tregojnë se vetëm gjashtë nga njëmbëdhjetë shërbimet publike të listuara (6/11) kanë të paktën më shumë se 50% të publikut në përgjithësi të kënaqur.

Qytetarët janë më shumë **të kënaqur**³⁰ me **furnizimin me ujë të pijshëm** (72%), **shërbimet policore** (66%) dhe **shërbimet e pastrimit** (ofruar në nivel vendor) (61%).


Në anën tjetër të spektrit, më shumë se gjysma e qytetarëve **nuk janë të kënaqur** me **shërbimet e punësimit** (78%), me **shërbimet e gjyqësorit** (66%) dhe me **shërbimet e mirëqenies sociale** (60%).



Gr. 38

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2016

■ Shumë i pakënaqur
 ■ I pakënaqur
 ■ I kënaqur
 ■ Shumë i kënaqur



Shënim: Përgjigjet "Pa opinion" nuk janë paraqitur në garfik.

Krahasim socio-demografik

Tabela 8 përmbledh rezultatet e analizës relacionale sipas karakteristikave socio-demografike të anketuarve.

Në një nivel të përgjithshëm, duket se ka pak ndryshim midis gjinive në kënaqshmëri në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike. Siç ishte rasti me nivelet e besimit (shih më lart), **segmentet me moshë më të madhe të popullsisë** prirën të jenë më të kënaqur me shërbimet publike në krahasim me brezat e rinj. Përveç kësaj, përsa i përket statusit të punësimit, pjesa e **punësuar** e demografisë duket më e kënaqur dhe për më tepër, brenda kësaj kategorie, kënaqshmëria është më e theksuar në mesin e të punësuarve në **sektorin publik**.

Megjithatë, klasifikimi **urban-rural** duket se është një faktor përcaktues i nivelit të kënaqshmërisë, ku qytetarët që jetojnë në zonat rurale kanë më shumë gjasa të raportojnë nivele të ulëta të kënaqshmërisë ndaj ofrimit të shërbimit publik në krahasim me ata që jetojnë në zonat urbane.

Grafiku 39 paraqet kënaqshmërinë neto³¹ lidhur me ofrimin e shërbimeve publike të ndara sipas këtij klasifikimi. Për shembull, duke u fokusuar në shërbimet që kanë të paktën më shumë se 50% të publikut në përgjithësi të kënaqur (nga e majta e panelit), diferenca e kënaqshmërisë neto shkon nga 6 p.p. për furnizim me ujë të pijshëm deri në 28 p.p. për shërbimet e pastrimit. Në anën tjetër të spektrit (e djathta e panelit), diferenca e kënaqshmërisë neto negative është 14 p.p. për shërbimet publike të kujdesit shëndetësor dhe 16 p.p. për shërbimet e mirëqenies sociale.

Gr. 39

Kënaqshmëria neto sipas klasifikimit urban-rural




Tabela 8. Analiza relacionale “Të kënaqur” ose “Shumë të kënaqur”


	Shërbimet shëndetësore	Shërbime arsimore	Transport publik	Shërbimet për mirëqenie sociale	Shërbimet e punësitëve	Shërbimet e urgjencës	Shërbimet e pastrimit	Lejet liqore	Shërbimet gjyqësore	Furnizimi me ujë të pijshëm	Shërbimet policore
TOTAL	47%	58%	55%	34%	18%	55%	61%	35%	21%	72%	66%
Gjinia											
Mashkull	45%	56%	54%	32%	17%	54%	60%	34%	20%	73%	65%
Femër	50%	60%	56%	37%	19%	57%	63%	35%	23%	71%	68%
Mosha											
18-25	45%	59%	51%	34%	16%	53%	60%	35%	23%	74%	63%
26-35	41%	57%	55%	34%	15%	54%	60%	31%	19%	70%	61%
36-45	46%	58%	52%	32%	18%	55%	61%	33%	19%	74%	66%
46-55	48%	56%	59%	31%	18%	55%	63%	39%	20%	73%	68%
56-65	53%	59%	55%	36%	20%	54%	59%	34%	19%	66%	65%
Over 66	56%	62%	62%	40%	23%	67%	71%	43%	32%	76%	80%
Arsimi											
Arsimi Bazë	48%	57%	55%	31%	14%	52%	53%	30%	23%	70%	66%
Shkollë e mesme	44%	56%	54%	31%	17%	57%	64%	35%	19%	71%	62%
Universitet	50%	62%	58%	43%	23%	56%	64%	39%	23%	76%	73%
Statusi i punësit											
Totali	52%	62%	57%	36%	23%	59%	66%	42%	22%	74%	69%
Të punësuar	65%	73%	62%	46%	33%	69%	69%	47%	27%	78%	76%
Privat	46%	58%	53%	29%	17%	53%	64%	39%	20%	73%	65%
Të papunë	39%	51%	52%	29%	10%	50%	55%	25%	17%	69%	60%
Pensionistë	54%	60%	62%	39%	25%	64%	69%	42%	30%	74%	77%
Studentë	42%	62%	49%	37%	16%	49%	55%	28%	20%	69%	59%
Rajoni											
Urban	50%	61%	57%	37%	18%	58%	68%	38%	22%	75%	72%
Rural	43%	55%	53%	31%	17%	52%	54%	32%	21%	69%	60%

Më tej, të anketuarit u pyetën në lidhje me sistemet e mundshme të ankimit që janë në funksionim dhe nëse ata iu besojnë këtyre sistemeve.

Të dhënat tregojnë se gjatë 12 muajve të fundit, rreth 16% e qytetarëve të anketuar (N = 252) raportojnë se kanë paraqitur një ankesë në lidhje me një shërbim të marrë në institucionet përkatëse. Megjithatë, nga kjo përqindje, vetëm 1 në 3 qytetarë (N = 84) raporton që ankesa e tyre është adresuar më pas; 50% e tyre (N = 125) deklarojnë se ankesa e tyre nuk është adresuar.


Gr. 40

Gjatë vitit 2016, a keni paraqitur ndonjë ankesë në institucionet e mësipërme për ndonjë shërbim të marrë?



Gr. 41


Në qoftë se ju keni dërguar ndonjë ankesë, a u adresua ankesa juaj?



Ky konstatim është në përputhje me rezultatin se vetëm 28% e qytetarëve të anketuar besojnë se institucionet dëgjojnë dhe trajtojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët, në krahasim me shumicën (ose 46%), të cilët nuk besojnë kështu. Shih grafikun 42.

Gr. 42

A besoni se institucionet "dëgjojnë" dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët?




Ofrimi i shërbimeve dhe besimi

Kur analizohet lidhja midis nivelit të kënaqshmërisë dhe besimit të raportuar për katër institucionet dhe shërbimet që ato ofrojnë (konkretisht, shërbimet shëndetësore, shërbimet e arsimit, shërbimet gjyqësore dhe shërbimet e policisë) besimi dhe kënaqshmëria priren të shkojnë dorë për dorë me përjashtime të vogla. Në rastin e shërbimeve shëndetësore, qytetarët kanë më shumë besim tek sistemi (50%), sesa janë të kënaqur nga ofrimi i shërbimeve (47%). Ndërsa, për rastin e policisë kjo situatë paraqitet e përmbytur. Shih grafikun 47.

Gr. 43

Besimi në institucione dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2016



Siguria në jetën e përditshme

Një shoqëri e sigurt është një kërkesë thelbësore e qytetarëve për mirëqenien e tyre. Për këtë qëllim, të anketuarit u pyetën nëse ata ndihen të sigurt në jetën e tyre të përditshme. Pak më shumë se gjysma (51%) e qytetarëve të anketuar raportojnë se nuk ndihen të sigurt në krahasim me 49% të atyre që pohojnë të kundërtën. Kjo ndjenjë pasigurie është më e përhapur ndër zonat rurale (57%) në krahasim me ato urbane (45%).

Analiza e të dhënave relacionale tregon se ata njerëz që raportojnë se ndihen të pasigurt kanë më pak besim tek policia (70% e tyre nuk priren t'i besojnë policisë) dhe ka më pak të ngjarë të jenë të kënaqur me shërbimet policore (76% e tyre janë të pakënaqur me shërbimet policore).

Arsyeja kryesore e raportuar për ndjenjën e pasigurisë është kriminaliteti (49%). Për shpërndarjen e përgjigjeve shih Tabelën 9.

Gr. 44

Në përgjithësi, a ndjeheni të sigurt në jetën tuaj të përditshme?




Tabela 9. Faktorë kryesorë për t'u ndier të pasigurt

Kriminaliteti	49%
Drejtësia	11%
Shëndeti	11%
Trafiku	7%
Përdorimi i drogës	6%
Politika	5%
Ndotja	3%
Dhuna në familje	3%
Ndarja e pabarabartë e pasurisë	3%
Liria e shprehjes	1%
Konfidencialiteti	1%


TIK (PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË)

Ky seksion analizon disa tregues për përdorimin e TIK-ut me qëllim për të shqyrtuar ndërveprimin elektronik midis qeverisë dhe elektoratit të saj. Reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare në lidhje me broadband, prezantimi i qeverisjes elektronike dhe teknologjisë digjitale kanë krijuar mundësi për rritjen e aksesit ndaj informacionit.

Të dhënat tregojnë se 42% e qytetarëve të anketuar kanë dijeni për ekzistencën e faqes së internetit të bashkisë së tyre përkatëse, ndërsa 52% janë përgjigjur “jo” dhe 6% “nuk e di” (shih grafiku 45).³²


Gr. 45

A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti?



Gr. 46

A e përdorni faqen e internetit të Bashkisë tuaj?



Vetëm atyre qytetarëve të cilët ishin në dijeni të ekzistencës së faqes së internetit iu kërkua që t’ju përgjigjeshin pyetjeve të tjera në këtë seksion (N = 692). Grafiku 46 tregon se 59% e qytetarëve të anketuar³³ (N=383) nuk e përdorin faqen e internetit të bashkisë, kurse 41% (N=266) e qytetarëve të anketuar e përdorin faqen e internetit të bashkisë për qëllime të ndryshme.

Tabela 8 tregon se nga 41% (N=266) e qytetarëve që përdorin faqen e internetit të bashkisë, 61% prej tyre (N=163) e përdorin atë për të marrë informacion (shikoj programe/ngjarje në qytetin/qytezën time). Ndërkohë, 22% (N=58) e tyre e përdorin faqen e internetit të bashkisë për të ndjekur vendimet e këshillit, duke lexuar procesverbalin e mbledhjeve etj., 11% e qytetarëve (N=28) e përdorin faqen e internetit të bashkisë për të dërguar ankesa, komente për një departament/stafin bashkiak dhe 6% e qytetarëve për të marrë shërbime.


Tabela 10. Përdorime të ndryshme të faqes së internetit të Bashkisë

Për të marrë informacion (kontroll programesh/ngjarjesh në qytetit/qytezën time)	Për të ndjekur vendimet e këshillit, lexuar process verbalet e mbledhjeve	Për të dërguar ankesa, komente në një department/stafin bashkiak	Për të marrë shërbime
61%	22%	11%	6%

Nga 42% e qytetarëve (të treguar në grafikun.45) që janë në dijeni për ekzistencën e një faqe interneti të bashkisë, vetëm 34% e tyre (N=232) janë të informuar në lidhje me shërbimet elektronike të ofruara nga bashkitë e tyre. 14% e qytetarëve nuk janë të informuar për shërbimet elektronike të ofruara nga bashkitë e tyre dhe 52% janë përgjigjur se nuk e dinë, siç tregohet në grafikun 47.

Gr. 47

I informuar nëse Bashkia ofron shërbime elektronike




Përgjigjet për pyetjen në lidhje me cilësinë e faqes së internetit përsa i përket ofrimit të informacionit dhe shërbimeve, tregojnë se 87% (N=230) e qytetarëve të anketuar e konsiderojnë informacionin të saktë, kurse 13% (N=35) e tyre besojnë se informacioni nuk është mjaftueshëm i saktë.

Për më tepër 63% (N=166) e qytetarëve të anketuar thanë se informacioni i dhënë në faqen e internetit është i pasur dhe i plotë. Në të kundërt 37% (N=96) e qytetarëve besojnë se informacioni i dhënë në faqen e internetit të bashkisë nuk është i plotë dhe i pasur. Në lidhje me pyetjen mbi “përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në faqen e internetit” 61% (N=163) e qytetarëve u përgjigj: “Po”, ndërsa 39% (N=102) ka thënë “Jo”.

Gr. 48


Cilësia e faqes së internetit në lidhje me informacionin e dhënë



Në lidhje me cilësinë e faqes së internetit në lidhje me ofrimin e shërbimeve, 83% (N=221) e qytetarëve janë përgjigjur se shërbimet e disponueshme në faqen e internetit janë funksionale, kundrejt 17% (N=44). Nga ana tjetër 86% (N=226) e qytetarëve janë përgjigjur se shërbimet e ofruara janë të lehta për t'u përdorur, ndërsa 14% (N = 37%) besojnë të kundërtën. Në lidhje me mekanizmin e përshtypjeve, 81% (N=214) e qytetarëve të anketuar (që e përdorin faqen e internetit të bashkisë) u përgjigjën se faqja e internetit të bashkisë i përfshin mekanizmat e përshtypjeve, në krahasim me 19% (N=51), që thonë se Bashkia nuk i përfshin.

Gr. 49

Cilësia e faqes së internetit për sa i përket ofrimit të shërbimeve




GJINIA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Së fundmi, të anketuarit janë pyetur për të dhënë mendimin e tyre mbi tri deklaratat kryesore që kanë të bëjnë me gjininë që përqëndrohen në (1) qëndrimet ndaj barazisë gjinore, (2) aksesin në shërbimet publike, dhe (3) konsiderimin gjinor të politikave publike. Të dhënat vënë theksin mbi ekzistencën e një hendeku në perceptimin mbi gjendjen aktuale të barazisë gjinore - me pjesën mashkullore të popullsisë që portretizon një status quo mëpozitive.

“Deklarata 1: Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”

Gr. 50

Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave




Shënim: Përgjigjet “Pa opinion” nuk janë paraqitur në grafik.

Në përgjithësi, vetëm 48% e shqiptarëve të anketuar besojnë se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare. Siç tregon grafiku 50, kjo përqindje bie në 37% kur konsiderojmë nën-popullatën e grave të anketuara, në krahasim me 55% të burrave.

“ Deklarata 2: Në Shqipëri, gratë dhe burrat kanë të njëjtin aksers në shërbimeve publike ”

Fig. 51

Në Shqipëri, gratë dhe burrat kanë qasje të njëjtë ndaj shërbimeve publike



Shënim: Përgjigjet “Pa opinion” nuk janë paraqitur në grafik.


Pjesa më e madhe apo 59% e qytetarëve të anketuar mendojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses në shërbimet publike. Megjithatë, këtë besim e ndajnë vetëm 55% e grave, në krahasim me 63% të burrave.

“ Deklarata 3: Në Shqipëri, nëpunësit publikë shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë ndaj grave dhe burrave ”

Pikëpamjen që nëpunësit publikë shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë ndaj grave dhe burrave e kanë 62% e qytetarëve të anketuar. Në vijim të dy deklaratave të mëparshme, kjo perceptohet vetëm nga 56% e grave në krahasim me 66% të burrave.

Fig. 52

Në Shqipëri, nëpunësit publikë shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave



Shënim: Përgjigjet “Pa opinion” nuk janë paraqitur në grafik.

Më tej, të anketuarit u pyetën për përvojat e tyre të diskriminimit në lidhje me aksesin në shërbimet publike përgjatë 12 muajve të fundit. Pjesa më e madhe e kampionit (ose 87%) raporton se nuk janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nënpunës civil. Megjithatë, 6% e tyre raportojnë se janë trajtuar ndryshe në bazë të gjinisë së tyre. Tabela 11 përmbledh shpërndarjen e rezultateve.

Tabela 11. Gjatë vitit 2016, a jeni trajtuar ndryshe nga një institucion/apo nënpuës civil, në bazë të:

Baza	Po, jam diskriminuar:
Gjinia	6%
Mosha	4%
Kombësia	1%
Orientimi seksual	0%
Aftësia e kufizuar	1%
Tjetër	1%

Gratë në vendim-marrjen vendore


Para zgjedhjeve të fundit vendore në vitin 2015, ndryshimet në Kodin Zgjedhor kërkuan një përfaqësim 50% të secilës gjini në listën e kandidatëve - me qëllim rritjen e numrit të grave në vendimmarrjen vendore.

Një vit pas zgjedhjeve lokale, të anketuarit u pyetën në lidhje me dijeninë dhe opinionet e tyre mbi përbërjen gjinore të këshillave të tyre bashkiake.

Së pari, 24% e qytetarëve të anketuar pohojnë se kanë dijeni që ka më shumë gra në këshillat e tyre përkatëse bashkiak, në krahasim me shumicën e tyre (ose 57%), të cilët nuk janë në dijeni të përbërjes gjinore të këshillave të tyre bashkiake.


Gr. 53

A jeni në dijeni nëse ka më shumë gra në Këshillin Bashkiak?



Gr. 54


A jeni të kënaqur me numrin aktual të grave në Këshillin tuaj Bashkiak?



Së dyti, shumica e qytetarëve të anketuar (ose 65%) besojnë se një numër në rritje i grave në këshillat bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 24% e tyre nuk e ndajnë këtë mendim. Nga ana tjetër, siç përshkruhet në grafikun 56, shumica e qytetarëve të anketuar (83%) mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat të mbajnë ndonjë post publik. Shiko tabelën 5 për përmbledhjen e këtyre rezultateve të ndara sipas gjinisë dhe zonës të banimit.

Gr. 55

A besoni se një numër në rritje i grave në Këshillin Bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore?



Gr. 56

A mendoni se gratë janë po aq të afta sa burrat që mbajnë ndonjë pozicion publik?




Tabela 12. Analiza relacionale sipas gjinisë dhe klasifikimit urban-rural

	A jeni në dijeni nëse ka më shumë gra në Këshillin Bashkiak?			A jeni të kënaqur me numrin aktual të grave në Këshillin tuaj Bashkiak?			A besoni se një numër në rritje i grave në Këshillin Bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore?		
Totali	24%	19%	57%	23%	14%	63%	65%	24%	11%
Gjinia									
Mashkull	24%	21%	55%	24%	13%	63%	57%	31%	12%
Femër	24%	17%	59%	21%	16%	63%	77%	15%	9%
Rajoni									
Urban	26%	17%	56%	24%	15%	60%	67%	23%	12%
Rural	22%	22%	58%	22%	14%	65%	63%	24%	10%

referencat

- BIRN Albania. (2016). Local Government under the Lens of Freedom of Information. Retrieved from <http://birn.eu.com/en/news-and-events/birn-albania-publishes-report-on-transparency-of-local-government>*
- Brodie et al. (2011). Pathways through Participation: What creates and sustains active citizenship?*
- Citrin, J. (1974). Comment: The political relevance of trust in government. The American Political Science Review 68 (3): 973-988.*
- European Commission. (2016). Albania 2016 Report.*
- Grimmelikhuijsen SG and Welch EW. (2012). Developing and testing a theoretical framework for computer-mediated transparency of local governments. Public Administration Review 72: 562-571.*
- Hetherington, M. J. (1998). The Political Relevance of Political Trust. The American Political Science Review, Vol. 92, No. 4, pp. 791-808*
- Kampen et al. (2006). Assessing the relation between satisfaction with public service delivery and trust in government. In Public Performance and Management Review, 29 (4): 387-404.*
- Levi, M. and L. Stoker. (2000). Political Trust and Trustworthiness. Annual Review of Political Science 3: 475-507.*
- Newton, K. (1997). Politics and the news media: Mobilization or videomalaise?, in R. Jowell, J. Curtice and A. Park et al. (eds), British Social Attitudes: The 14th Report, 1997/98, Aldershot, UK: Ashgate.*
- Norris, P. (1999). Critical Citizens: Global Support for Democratic Government Oxford University Press.*
- Norris, P. (2000). The Virtuous Circle New York: Cambridge University Press.*
- OECD. (2013). Government at a glance 2013. OECD Publishing.*
- OECD. (2009). Focus on Citizens: Public Engagement for Better Policy and Services. OECD Publishing.*
- World Bank. (2012). Public office private interests: Accountability through Income and Asset Disclosure, Washington DC*

Shtojca 1

Nr.	Qark	Zonë urbane	Zonë Rurale	Nr. i Pyetsorëve
		Qendër Bash-kiake	Njësi Administra-tive	
		Berat	Otlak	27 (duke ruajtur një shpërndarje të barabartë midis zonave urbane dhe rurale)
1	Berat	Ura Vajgurore	Poshnjë	27
		Kuçovë	Kozarë	27
		Skrapar	Qendër Skrapar	27
		Poliçan	Tërpan	27
		Peshkopi	Maqellarë	27
2	Dibër	Bulqizë	Ostren	27
		Burrel	Ulëz	27
		Klos	Xibër	27
3	Durrës	Durrës	Ishëm	27
		Shijak	Maminas	27
		Krujë	Fushë Krujë	27
		Elbasan	Labinot	27
		Cërrik	Gostimë	27
4	Elbasan	Belsh	Grekan	27
		Peqin	Përparim	27
		Gramsh	Pishaj	27
		Librazhd	Hotolisht	27
		Përrenjas	Qukës	27
		Fier	Cakran	27
		Roskovec	Kuman	27
5	Fier	Patos	Sharrëz	27
		Lushnjë	Golem	27
		Divjakë	Grabian	27
		Ballsh	Selitë	27

		Gjirokastrë	Antigonë	27	
		Libohovë	Qendër Libohovë	27	
6	Gjirokastrë	Memaliaj	Memaliaj Fshat	27	
		Përmet	Petran	27	
		Këlcyrë	Kelcyrë Fshat	27	
		Tepelenë	Dukat	27	
		Dropull	Pogon	27	
			Korçë	Vithkuq	27
			Maliq	Libonik	27
7	Korçë	Pustec	Pustec fshat	27	
		Ersekë	Novoselë	27	
		Bilisht	Hoçisht	27	
		Pogradec	Udënisht	27	
			Kukës	Bicaj	27
			Krumë	Golaj	27
8	Kukës	Bajram Curri	Margegaj	27	
			Lezhë	Shëngjin	27
9	Lezhë	Rrëshen	Rubik	27	
		Laç	Milot	27	
			Shkodër	Rrethinat	27
10	Shkodër	Koplik	Gruemire	27	
		Pukë	Gjegjan	27	
		Vau Dejës	Bushat	27	
		Fushë Arrrëz	Fierzë	27	
			Tiranë	Petrelë	27
11	Tiranë	Kamëz	Paskuqan	27	
		Vorë	Bërxullë	27	
		Kavajë	Luz i vogël	27	
		Rrogozhinë	Kryevidh	27	
			Vlorë	Orikum	27
12	Vlorë	Selenicë	Vllahinë	27	
		Himarë	Lukovë	27	
		Sarandë	Ksamil	27	
		Konispol	Xarrë	27	
		Finiq	Livadhja	27	

Shtojca 2: Karakteristikat e kampionit 2013-2016

	2013	2014	2015	2016
Gjinia				
Mashkull	45%	49%	50%	57%
Femër	55%	50%	50%	43%
Grup moshat				
18-25	14%	23%	23%	18%
26-35	14%	22%	25%	23%
36-45	14%	18%	16%	19%
46-55	19%	18%	17%	18%
55-65	20%	10%	11%	13%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%
Niveli i arsimit				
I paarsimuar	1%	1%	2%	0%
Arsim bazë (9 vjeçare)	14%	15%	14%	25%
Shkollë e mesme	40%	41%	40%	51%
Universitet	44%	42%	43%	24%
Statusi i punësimit				
I/e punësuar	40%	46%	45%	43%
I/e papunësuar	20%	25%	28%	35%
Student/e	8%	10%	9%	8%
Pensionist/e	26%	9%	11%	12%
Tjetër	3%	5%	7%	2%

Shënim: Refuzimet nuk janë përfshirë.

poshtëshenime

1. Referoju shtojcës.
2. Ndërsa ishin në terren, intervistuesit patën vështirësi në rekrutimin e grave si pjesëmarrëse në sondazh. Kjo ishte veçanërisht për rastin e zonave rurale në pjesën veriore të vendit. Gjithashtu, individët me nivel më të ulët arsimi, ishin më të gatshëm për të marrë pjesë në sondazh. Kjo solli dy implikime: Proporcioni i grave ishte më i ulët se i burrave (43% vs. 57%). Pjesa më e madhe e të anketuarve (51%) kishin përfunduar shkollën e mesme.
3. Literatura sugjeron se karakteristikat socio-demografike si moshë, arsimi, të ardhurat dhe gjinia janë përcaktues të nivelit të besimit. Shiko: Arnold, Christine et al. (2012): 'Trust in the institutions of the European Union: A cross-country examination, European Integration online Papers, (EIoP), Special Mini-Issue 2, Vol. 16, Article 8.
4. DS tregon devijimin standard.
5. Nëse njerëzit perceptojnë se qeveria ndjek objektiva politike me të cilat ata pajtohen, atëherë ata duhet të kenë më shumë besim tek qeveria.
6. Si përhapës të informacionit pozitiv dhe negativ që njerëzit marrin rreth qeverisjes.
7. Tre institucione jo shqiptare, i janë shtuar listës, kryesisht për shkak të shkallës së lartë të përfshirjes së këtyre institucioneve në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të shoqërisë shqiptare.
8. Përgjatë gjithë raportit, për arsye të analizës, kategoritë (1-2) dhe kategoritë (3-4) të vlerësimeve verbale janë bashkuar në dy kategori të mëdha: prirjen të besojnë dhe nuk prirjen të besojnë.
9. % e qytetarëve të anketuar që shprehin "Kam shumë besim" ose "Kam besim".
10. Shih më sipër.
11. Kjo i referohet ndryshimeve të pikëve të përqindjes.
12. % e të anketuarve që shprehin "Nuk kam besim" ose "Nuk kam fare besim".
13. Shih më sipër.
14. % e të anketuarve që shprehen "Kam shumë besim" ose "Kam besim".
15. Përqindjet janë rrrullakosur në përqindjen më të afërt.
16. Për shembull, grafika dhe portretizimi i imazhit ose sensacionalizmi i krimit.
17. "Transparenca është disponueshmëria e informacionit në lidhje me një organizatë apo aktor që lejon aktorët e jashtëm të monitorojnë punët e brendshme ose performancën". Kështu, transparenca do të përfshinte perspektivat si të shtetit dhe të publikut për dhënien dhe aksesin për informacion (transparenca aktive dhe pasive), pjesëmarrjen e qytetarëve në proces dhe rrjedhimisht kapacitetin e tyre për të vlerësuar funksionimin e autoriteteve.
18. N tregon numrin e vëzhgimeve.

19. BIRN Albania. (2016). Pushteti vendor nën lanten e të drejtës për informim. Marrë nga <http://birn.eu.com/en/news-and-events/birn-albania-publishes-report-on-transparency-of-local-government>
20. *po aty*, 6.
21. *Po aty*.
22. *Kjo ishte një pyetje e hapur. Në grafik janë të përfshirë tri institucionet më të përmendura.*
23. *Qytetarë që kanë marrë shërbime.*
24. BIRN Albania. (2016). Pushteti vendor nën lanten e të drejtës për informim. Marrë nga <http://birn.eu.com/en/news-and-events/birn-albania-publishes-report-on-transparency-of-local-government>.
25. *64% e të anketuarve të cilët nuk kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit, domethënë 38% në nivel qendror dhe 32% në nivel vendor.*
26. *Ligj nr. 13/2016 datë 18.2.2016 Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë.*
27. *Dokumenti i Politikave Afatgjatë mbi ofrimin e Shërbimeve duke pasur në qendër qytetarin nga ana e institucioneve të qeverisë qendrore në Shqipëri. Marrë nga <http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2016/10/GoA-Citizen-Centric-Service-Delivery-Policy-Document2c-April-2016.pdf>*
28. *Ligji nr. 115/2014, "Mbi ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".*
29. *Ligji nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore".*
30. *% e të anketuarve të shprehur "Të kënaqur" ose "Shumë të kënaqur".*
31. *"Kënaqshmëria neto" përcaktohet si diferenca ndërmjet përqindjes së të anketuarve që janë përgjigjur "shumë të kënaqur" ose "të kënaqur" dhe "shumë të pakënaqur" dhe "të pakënaqur", duke mos marrë parasysh përgjigjen "nuk e di". Mund të jetë një vlerë pozitive, që do të thotë se mesatarisht, qytetarët priren të jenë të kënaqur me këtë shërbim, ose një vlerë negative, që do të thotë që në përgjithësi, qytetarët priren të jenë të pakënaqur me të.*
32. *31 / 61 Bashkitë kanë faqe zyrtare interneti (manualisht të kontrolluara në janar 2017).*
33. *Në dijeni të ekzistencës së faqes së internetit të Bashkisë*

